

**AKT THEMELIMI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“ÇILI CIVIL PROJECT” SH.P.K.**

Sot, me date 10/10/2022 (dymije e njezete e dy), i pranishme:

- **Z. Henri Çili**, shtetas shqiptar, i biri i Sherifit, lindur me 05.11.1975 ne Elbasan e banues ne Tirane, mbajtes i Leternjoftimit ID me Nr. 030722484, dhe me numer personal H51105114N, madhor e me zotesi te plete juridike e per te vepruar;

ne cilesine e ortakut te vetem themelues shpall hartimin dhe nenshkrimin e ketij Akt Themelimi ne perputhje me legjislacionin shqiptar dhe me termat si me poshte vijon:

**NENI 1
EMERTIMI**

Themelohet nje shoperi tregtare me pergjegjesi te kufizuar me emertimin “**ÇILI CIVIL PROJECT**”, ose me akronimin (**CCP**).

**NENI 2
SELIA**

Selia e shoqerise ndodhet ne Tirane, ne adresen: Rruga “Xhanfize Keko” Nr. 56, ZK. 8130, nr. Pasurie 5/752 Tirane, Shqiperi. Shoqeria, me vendim te Asamblese se per gjithshme te ortakeve, mund te hape seli dyesore, filiale, zyra perfaqesimi, dege ose agjensi si ne Shqiperi ashtu edhe jashte saj.

**NENI 3
KOHEZGJATJA**

Kohezgjatja e veprimtarise se shoqerise eshte e pakufizuar. Afati fillon nga momenti i regjistrimit te shoqerise ne Regjistrin e Shoqerive Tregetare deri sa te mbyllte me akte ligjore.

**NENI 4
OBJEKTI**

Objekti i Shoqerise eshte:

- Ofrimi i sherbimeve dhe konsulencave profesionale ne fushen ekonomike.
- Ofrimi i sherbimeve dhe konsulencave profesionale ne fushen e marketingut dhe Public Relationship (PR).
- Konsulence dhe asistence ne menaxhim projektesh ne fusha te ndryshme te jetes sociale.
- Ndermjetesim ne fusha te ndryshme
- Aktivite te ndryshme ne fushen e Real Estate.
- Analiza te detajuara te gjendjes ekonomike dhe raportimi ne formen e due diligence.
- Ofrimin e sherbimit si nje qender per praktiken e keshillimit per studente universitar, si

dhe nje qender e kerkimit shkencor ne psikologji.

- Botime Gazetash;
- Botime Revistes;
- Botime te librave me tematika te ndryshme;
- Perkthime te literaturave te huaja me tematika te ndryshme;
- Ritjen e profesionalizmit dhe te pergjegjesise ne profesionin e gazetarise, si nje profesion ne ndihme te zhvillimit dhe te informimit te perditshem ne jeten sociale, kulturore, ekonomike, sportive, politike, etj.;

Gjithashtu per te realizuar objektin dhe qellimet e saj, Shoqeria mund te ndermarre dhe zhvilloje cdo lloj aktiviteti tregtar, finanziar, promocional, etj. qe i vlereson te dobishme apo te nevojshme per arritjen e qellimeve te saj.

NENI 5 **KAPITALI THEMELTAR**

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100.000 ALL (nje qinde mijë leke) dhe eshte i perbere nga 1 (nje) kuote me vlore nominale 100.000 ALL (nje qinde mijë leke).

Kapitali themeltar zoterohet totalisht nga ortaku i vetem **Z. Henri Çili**, shtetas shqiptar, i biri i Sherifit, lindur me 05.11.1975 ne Elbasan e banues ne Tirane, mbajtes i Leternjoftimit ID me Nr. 030722484, dhe me numer personal H51105114N.

NENI 6 **ORGANET E SHOQERISE**

Organet e shoqerise jane Asambleja e per gjithshme dhe organi administrativ. Asambleja e per gjithshme e ortakeve eshte organi vendimmarres i shoqerise dhe vepron ne perputhje me statutin e shoqerise dhe ligjet ne fuqi.

Organi i vetem Administrativ i shoqerise eshte Administratori i saj i vetem

- **Z. Erind Trungu**, shtetas shqiptar, lindur me 22.05.2000 ne Elbasan e banues ne Tirane, mbajtes i leternjoftimit me nr. 033594160 dhe nr. personal K00522020L, madhor e me zotesi te plotë juridike per te vepruar,

qe do te qendroje ne detyre per nje preriudhe prej 5 vjetesh me te drejte rizgjedhjeje.

Administratori ka te gjitha kompetencat per administrimin e zakonshem te shoqerise, ne perputhje me sa parashikohet nga ligji, nga akti i themelimit dhe nga statuti i shoqerise. Administratori ka te drejta dhe kompetencia te plota per kryerjen e te gjitha veprimeve qe do te konsideroje te dobishme per realizimin e objektivave te shoqerise, me perjashtim te atyre qe kerkojne miratimin paraprak te Asamblese se per gjithshme.

Administratori perfaqeson shoqerine ne marredhenie me te tretet, perpara organeve shteterore dhe private.

NENI 7 **PJESEMARRJA NE SHOQERI TE TJERA**



Ortaket mund te vendosin lirisht pjesemarrjen ne shoqeri te tjera si dhe te fillojne çdo lloj aktiviteti tjeter tregtar ne territorin e Shqiperise, me kushtin qe te mos jete konkuries me ate te shoquerise se themeluar prej tyre.

Cdo veprimtari qe bie ndeshe me paragrafin e siperpermendur nuk do te konsiderohet si konflikt interes i nese mer votbesimin e te pakten 51% (pesedhjete e nje perqinde) te ortakeve. Do te konsiderohen te perjashtuara nga kufizimi i mesiperm marredheniet dhe veprimtarite tregtare qe mund te ushtrohen prej ortakeve jashte Republikes se Shqiperise.

NENI 8
LEGJISLACIONI I APLIKUESHEM

Veprimtaria e shoquerise do te rregullohet nga dispozitat e statutit te shoquerise, si dhe nga te gjitha dispozitat ligjore ne fuqi ne Republiken e Shqiperise.

NENI 9
ZGJIDHJA E MOSMARREVESHJEVE

Mosmarrëveshjet që mund të lindin ndermjet ortakeve ose ndermjet ortakeve dhe shoquerise dhe qe ka lidhje me te drejta te disponueshme ne lidhje me marredheniet e tyre me shoquerine do t'i drejtohen per zgjidhje Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane.

NENI 10
DISPOZITA FINALE

Ky akt themelimi u hartua ne kater kopje te njejtave ne gjuhen shqipe, u lexua e u pranua nga ortaku i shoquerise, i cili njekohesisht autorizon Z. Betim Shkupi per depozitim e ketij Akti Themelimi dhe Statutit te Shoquerise prane Qendres Kombetare te Regjistrimit.

ORTAKU THEMELUES

